



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 6 regjistër (JR)
Datë 05.02.2020

Nr. 34 i vendimit
Datë 15.11.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian Hajdari	Kryesues
Sokol Çomo	Relator
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 15.11.2021, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatini, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 6 (JR), datë 05.02.2020, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Isuf Shehu, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, përfaqësuar nga avokate Lirime Cukaj me nr. licence 3094, anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, në bazë të prokurës së posaçme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.10.2019, para noterit të Dhomës së Noterisë Tiranë A. B. S..

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 210, datë 14.11.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Isuf Shehu.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet A deri në F të Aneksit të Kushtetutës, nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Kodi i Procedurës Civile dhe neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të

gjqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimit e subjektit të rivlerësimit Isuf Shehu, të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 210, datë 14.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Isuf Shehu, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarit dhe njëkohësisht kryetarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për rrjedhojë ai gëzon statusin e magjistratit¹. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, z. Isuf Shehu iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) brenda afatit ligjor², në përputhje me nenet 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë³.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Ka kryer deklarim të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë Gjyqësor (sikundër shprehet në vendimin e tij nr. 210, datë 14.11.2019⁴), kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Isuf Shehu, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë vendimin nr. 210, datë 14.11.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 210, datë 14.11.2019, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Isuf Shehu, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës [...]”.
6. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 59, pika 1 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi Komisioni vlerësoi se në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, subjekti i rivlerësimit nuk ka

¹ Neni 2, pika “gj” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se magjistrat është edhe gjyqtari (kryetarët e gjykatës), ndërkohë neni 164, pika 2 e të njëjtit ligj parashikon se gjyqtarët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar sipas të njëjtit ligj, vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit.

² Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

³ Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 26.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. extra prot., datë 26.01.2017. Të njëjtën datë mban edhe deklarata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

⁴ Shih paragrafin 2, faqe 2 e vendimit të Komisionit nr. 210, datë 14.11.2019.

arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

6.1. Në lidhje me pasurinë e identifikuar me nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me kohën e ndërtimit të pasurisë, pasi nuk ka deklaruar ndërtimin e kësaj pasurie vit pas viti, minimalisht, siç e ka deklaruar gjatë hetimit administrativ se në vitin 2003 kishte përfunduar bodrumi dhe kati i parë dhe nuk ka deklaruar saktësisht përfundimin e këtij ndërtimi në vitin 2005, sikurse ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të depozituar tek ALUIZNI; ka kryer deklaram të rremë lidhur me vlerën reale të shpenzuar për ndërtimin e kësaj pasurie, është në mungesë burimesh financiare në vlerën 5.220.152 lekë për ndërtimin e kësaj pasurie, si dhe për të kryer shpenzime të tjera familjare.

6.2. Në lidhje me pasurinë e identifikuar me nr. 2, subjekti i rivlerësimit është në mungesë burimesh financiare në vlerën 938.091 lekë për të blerë automjetin, për të paguar zhdoganimin dhe për të kryer shpenzime të tjera familjare; ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e vitit 2010, pasi nuk ka deklaruar pagesën e zhdoganimit të automjetit; ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi deklaroi shpenzime zhdoganimit në vlerën 260.102 lekë, ndërsa nga dokumentacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRR”), shpenzimet e zhdoganimit rezultuan në vlerën 470.254 lekë.

6.3. Në lidhje me pasurinë e identifikuar me nr. 3, subjekti është në mungesë burimesh financiare në vlerën 449.482 lekë për të blerë automjetin, për të paguar zhdoganimin dhe për të kryer shpenzime të tjera familjare.

III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar “Kolegji”) me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 210, datë 14.11.2019, me pretendimin se procesi i kryer në Komision dhe vendimi i dhënë vetëm për një kriter rivlerësimi (kriterin e vlerësimit të pasurisë) është rezultat i një hetimi administrativ të njëanshëm, të paracaktuar, i realizuar në kundërshtim të plotë me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, si dhe në shkelje të parimeve që garantojnë të drejtën e subjektit për proces të rregullt ligjor.
8. Subjekti i rivlerësimit Isuf Shehu, ankimin e tij e ka shoqëruar me disa akte shkresore për të cilat kërkoi marrjen e tyre në cilësinë e provave të reja. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe neneve 51, pika 1 dhe 53, germa “b” e ligjit nr. 49/2012, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - *Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, marrjen e provave të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit, ose administrimin e provave të depozituara. Hetimin edhe për dy kriteret e tjera kushtetuese, atë të vlerësimit të pastërtisë së figurës dhe të aftësisë profesionale.*
 - *Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 210, datë 14.11.2019.*
 - *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.*
9. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale, si dhe ato të zbatimit të ligjit material, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

9.1. Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon

plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.

9.2. *Komisioni ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të kuptimit të konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm.*

9.3. *Është cenuar e drejta e subjektit për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), si pasojë e mosrespektimit nga ana e Komisionit e parimit të barazisë së armëve, parimit të kontradiktoritetit, të drejtës së subjektit për të kërkuar marrjen e provave, për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.*

10. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

◦ Lidhur me pasurinë e paluajtshme “ndërtesë 3 kate + bodrum”, me sipërfaqe trualli 229,95 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 348,15 m², në Kukës:

10.1. *Subjekti kundërshtoi si të pabazuara konkluzionet e Komisionit për deklarim të pasaktë, deklarim të rremë, fshehje të pasurisë dhe mungesë burimesh të ligjshme në lidhje me financimin për ndërtimin e banesës 3 kate + bodrum.*

10.2. *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë përlllogaritjen e vlerës së ndërtimit nga ana e Komisionit dhe shpërndarjen e kostos ndër vite, si pasojë e pretendimeve në lidhje me vitin e përfundimit të ndërtimit.*

◦ Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit “automjet” të tipit Mercedes Benz, blerë në vitin 2011, në vlerën 500.000 lekë:

10.3. *Subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për deklarim të rremë të vlerës së automjetit dhe mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e tij.*

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. *Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Isuf Shehu, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë

Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁵ nga data e njoftimit të vendimit të këtij të fundit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016. Ankimi i subjektit të rivlerësimit është nënshkruar nga avokatja e tij me prokurë, znj. Lirime Cukaj, dhe është shoqëruar me aktin e përfaqësimit⁶, në përputhje me parashikimet e nenit 46, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Nëpërmjet këtij akti përfaqësimi, subjekti i rivlerësimit ka pajisur përfaqësuesen e tij, znj. Lirime Cukaj, ndër të tjera, me tagrat e mëposhtëm:

- *Të më përfaqësojë pranë KPK (Komisioni i Pavarur i Kualifikimit), KPA (Komisioni i Pavarur i Apelit), dhe po lindi nevoja në gjykatë e në të gjitha shkallët e gjyqësorit, për sa jam subjekt i rivlerësimit të Komisioneve si më sipër.*

- *Të ushtrojë të drejtën e ankimit kundër vendimeve të ndërmjetme e përfundimtare të komisioneve apo dhe hetimit të tyre, të ushtrojë të drejtën e apelit e të rekursit, prapësime, të administrojë e të tërheqë prova në çdo institucion privat apo shtetëror, nëse do të lindë nevoja të kërkojë ndryshim të trupës, të thërrasë dëshmitarë, ekspertë, specialistë apo dhe t'i përjashtojë ata sipas rrethanave dhe fazave të hetimit apo dhe shqyrtimit gjyqësor [...].*

12. Trupi gjykues konstatoi se prokura e sipërcituar paraqet problematika në drejtim të emërtesës së Kolegjit pranë të cilit është depozituar për shqyrtim ankimi i ushtruar në emër të subjektit të rivlerësimit nga avokatja Lirime Cukaj. Megjithatë, kjo e metë çmohet se nuk ka cenuar tagrin e përfaqësuesit me prokurë për të ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 210, datë 14.11.2019, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
14. Sa u takon akteve shkresore që subjekti i ka bashkëlidhur ankimit të tij, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

⁵ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 210, datë 14.11.2019, për rivlerësimin e subjektit Isuf Shehu, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 16.01.2020, konfirmuar marrja dijani nga subjekti i rivlerësimit më datë 20.01.2020, sipas lajmërim-marrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision në datën 28.01.2020, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {***}, datë 28.01.2020, që rezulton të jetë dita e 8-të nga data e marrjes dijani për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit Isuf Shehu e ka dorëzuar ankimin e tij në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

⁶ Prokurë e Posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.10.2019, para noterit të Dhomës së Noterisë Tiranë A.B.S.

15. Në kuadër të sa më sipër, lidhur me (i) “Relacionin Financiar të hartuar nga “{***}”ShPK”, me anë të të cilit subjekti i rivlerësimit kërkoi të provojë ekzistencën e burimeve të ligjshme për përballimin e jetesës dhe investimin e kryer në pasuri; dhe (ii) “Aktin e ekspertimit teknik të përgatitur nga ing. I. S. dhe Spv. Ark. I. S.”, me anë të të cilit kërkoi të provojë vlerën totale të punimeve të kryera për ndërtimin e objektit “shtëpi banimi 3 kate + bodrum”, trupi gjykues konstatoi se gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur më datë 23.10.2019, në kuadër të shpjegimeve të tij ndaj rezultateve të hetimit administrativ një relacion financiar të përpiluar nga i njëjti ekspert, si dhe në kuadër të të provuarit të vlerës së pasurisë “ndërtesë 3 kate + bodrum” ka dorëzuar në Komision një preventiv punimesh dhe një relacion shpjegues të përpiluar nga ing. D. D., akte këto të cilat Komisioni i ka vlerësuar dhe është shprehur lidhur me to në vendimin e tij të arsyetuar. Trupi gjykues vëren se me aktet bashkëlidhur ankimit, subjekti i rivlerësimit synon të prezantojë një variant të ndryshëm të aktit të vlerësimit të pasurisë, duke paraqitur një vlerë të re të kostos së objektit dhe, për rrjedhojë, prezantimin e një relacioni financiar i cili analizon situatën financiare bazuar mbi rezultatin e aktit të ri të vlerësimit të pasurisë. Trupi gjykues konstatoi se subjekti nuk ka pasur asnjë pengesë për të dorëzuar në Komision këto akte, në vend të atyre që ka dorëzuar fillimisht. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se këto dy akte të dorëzuara në cilësinë e provave të reja, nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, për t’u pranuar si të tilla nga trupi gjykues.
16. Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjykues çmoi gjithashtu se debati gjyqësor nuk është i nevojshëm dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së mësipërme, lidhur me kërkesat e subjektit për marrjen e provave të reja, në kuadër të kërimit të tij në ankim për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe hetimit administrativ edhe të dy kritereve të tjera të rivlerësimit, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me aspektet procedurale, si dhe ato të zbatimit të ligjit material

17. Lidhur me shkakun e ankimit sipas të cilit subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues vlerësoi se tashmë Kolegji ka krijuar jurisprudencë të konsoliduar⁷ në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës vlerësimi për secilin kriter rivlerësimi (atë të pasurisë dhe pastërtisë së figurës) është i pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat

⁷ Shih vendimet e Kolegjit nr. 9 (JR), datë 24.10.2018; 7 (JR), datë 05.04.2019; nr. 28 (JR), datë 30.10.2019 etj.

e parashikuara nga nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit të rivlerësimit për kriterin objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjeti këtë pretendim të pabazuar në ligj dhe, si i tillë, ai nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.

18. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se Komisioni ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 edhe në drejtim të kuptimit të konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm. Subjekti parashitroi se deklarimi vlerësohet i pamjaftueshëm nëse përmban një nga situatat e përcaktuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat, për sa kohë sjellin të njëjtën pasojë, atë të parashikuar në nenin 61, pika 3 e të njëjtit ligj, që përbën shkak për shkarkimin e subjektit nga detyra, duhet të jenë në të njëjtin nivel rëndësie dhe provueshmërie, si dhe të përbëjnë sjellje të rëndë të subjektit të rivlerësimit të një niveli të njëjtë ose të përafërt. Subjekti sqaroi se, me sa më sipër parashtruar, pretendon se mungesa e burimeve financiare për të justifikuar pasuritë (germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016) mund të përbëjë deklarim të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vetëm nëse është në atë nivel të rëndë shkeljeje, të krahasueshëm ose të barabartë me fshehjen e pasurisë, deklarimin e rremë ose situatën e konfliktit të interesit. Sipas subjektit, Komisioni në këtë rast nuk është udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit në marrjen e vendimit për shkarkim, për sa kohë ai nuk ndodhet në kushtet e nenit D, pikat 4 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilave subjekti prezumohet fajtor dhe ndaj tij jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.
19. Lidhur me shkakun e mësipërm të ankimit, i cili ka të bëjë me interpretimin e konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësuar ky në raport me konstatimet e procedurës së vlerësimit të pasurisë sipas nenit 33, pika 5 e të njëjtit ligj, trupi gjykues çmon se pretendimet në të cilat subjekti i rivlerësimit mbështet këtë shkak ankimi, janë të pabazuara në ligj, për sa kohë konstatimet e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat mund ta vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, nuk vlerësohen në raport me njëra-tjetrën, por shihen si të pavarura, vlerësimi i të cilave në kuadër të prodhimit të pasojave të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, u nënshtrohet parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit.
20. Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka cenuar parimin e barazisë para ligjit të subjekteve të rivlerësimit, si pasojë e zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar me standarde të dyfishta, duke qenë se në raste të ngjashme ka mbajtur standarde të ndryshme kuptimi dhe vlerësimi të kësaj dispozite, në vlerësim të trupit gjykues një pretendim i tillë i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak procedural për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat lidhen me vlerësimin e kriterëve të rivlerësimit, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar me vendimmarrje të mëparshme të tij⁸.
21. Subjekti i rivlerësimit pretendoi cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), si pasojë e mosrespektimit nga ana e Komisionit të parimit të barazisë së armëve, parimit të kontradiktoritetit, të së drejtës së subjektit për të kërkuar marrjen e provave, si dhe të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

⁸ Shih vendimin e Kolegjit nr. 7 (JR), datë 05.04.2019.

22. Në mbështetje të këtij shkakui ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se mosbërja me dije ose moshetimi administrativ edhe për dy kriteret e tjera, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, e bën vendimin e Komisionit paragjykes dhe të paracaktuar nga kjo trupë administrative. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendoi se refuzimi i riçeljes së hetimit administrativ nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, mosmarrja prej tij e provave të kërkuara nga subjekti (marrja e disa personave në cilësinë e dëshmitarëve, si dhe marrja e provës me ekspert), mosçelja e hetimit për dy kriteret e tjera të rivlerësimit përbëjnë mohim të së drejtës për t'u dëgjuar, për të prapësuar dhe për të paraqitur kundërargumentet e tij në lidhje me konstatimet e Komisionit. Subjekti pretendoi edhe se nuk është gjykuar nga një gjykatë e paanshme, duke qenë se e njëjta trupë e cila ka kryer hetimin administrativ, ka vlerësuar provat e paraqitura nga subjekti, si dhe ka marrë vendimin për shkarkimin e tij nga detyra.
23. Në vlerësim të shkakut të mësipërm të ankimit, fillimisht sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për vendim paragjykes dhe të paracaktuar, duke qenë se nuk janë hetuar dy kriteret e tjera të rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues, nga verifikimi i procedurave të ndjekura nga ana e Komisionit, konstatoi se me vendimin e tij nr. 1, datë 22.03.2018, ka nisur *hetimi administrativ mbi procedurën e rivlerësimit nga relatori* dhe se me vendimin nr. 2, datë 09.10.2019, "Për mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Isuf Shehu" është vendosur: "Të përfundojë hetimi kryesisht për subjektin e rivlerësimit Isuf Shehu, vetëm për kriterin e pasurisë, bazuar në relacionin "Mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Isuf Shehu". Në hyrje të dokumentit të rezultateve të hetimit administrativ, citohet: *Pasi u analizuan raportet e dërguara nga institucione, si: ILDKPKI, DSIK dhe KLGj, Komisioni filloi hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vlerësimin mbi pastërtinë e figurës, si dhe vlerësimin profesional, duke kërkuar informacion nga subjekte të së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.* Nga sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vëren se, në rastin konkret, Komisioni ka nisur procedurën e hetimit administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit dhe në vijim, ka arritur në konkluzionin se provat e administruara gjatë hetimit administrativ për kriterin e pasurisë kanë pasur nivelin e provueshmërisë sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, Komisioni ka vlerësuar se subjektit të rivlerësimit mund t'i kalonte barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ. Një situatë e tillë procedurale çmohet nga trupi gjykues se nuk bie ndesh me parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi dhe nuk demonstroi as paragjykim të trupës gjykuese të Komisionit apo paracaktim të vendimit. Në vijim të sa më sipër, gjendet i pabazuar edhe pretendimi se mosçelja e hetimit për dy kriteret e tjera të rivlerësimit përbën mohim të së drejtës për t'u dëgjuar, për të prapësuar dhe për të paraqitur kundërargumentet e tij në lidhje me konstatimet e Komisionit, për sa kohë rezulton se Komisioni nuk ka arritur në konkluzion lidhur me vlerësimin e këtyre dy kriterëve dhe se vendimi i tij, që ka sjellë pasoja ligjore për subjektin e rivlerësimit, nuk është bazuar në vlerësimin e këtyre kriterëve të rivlerësimit, pa i garantuar më parë subjektit të drejtën të shprehet/shpjegohet dhe mbrohet lidhur me gjetjet mbi to.
24. Sa i takon pretendimit të ngritur në drejtim të mosmarrjes së provave nga Komisioni, trupi gjykues, pasi vlerësoi aktet e fashikullit të Komisionit lidhur me këtë çështje, konstatoi se subjekti i rivlerësimit më datë 22.10.2019, kishte depozituar një kërkesë për marrjen e provës me dëshmitarë dhe të provës me ekspertë vlerësues pasurish dhe/ose inxhinier ndërtimi. Kjo kërkesë rezulton të jetë trajtuar nga trupi gjykues i Komisionit, i cili më datë 23.10.2019, ka marrë vendim: *Të pranohet pjesërisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit, z. Isuf Shehu.* Më konkretisht, Komisioni rezulton se ka administruar në cilësinë e provës aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, përkatësisht deklaratën noteriale nr. {***} rep, nr. {***} kol, datë 15.10.2019, të shtetasve Z.B. dhe A. Sh, si

dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. kol {***}, datë 15.10.2019, të shtetasit Xh. C., provat e renditura me nr. 1, 2, 3 [...] në fund të “Shpjegimeve në lidhje me rezultatet e hetimit të subjektit të rivlerësimit”, të depozituara në mënyrë elektronike pranë Komisionit më datë 23.10.2019. Komisioni ka vendosur gjithashtu të refuzojë kërkesën për marrje provash me dëshmitarë të shtetasve Xh. Sh., A. Sh., Xh T., S. G., Z. B., A. Sh. dhe Xh. C., si dhe kërkesën për caktimin e një grupi ekspertësh të pavarur që të përcaktojnë vlerën reale të ndërtimit të sendit.

25. Trupi gjykues konstatoi se vendimi i Komisionit i datës 23.10.2019, me të cilin është disponuar lidhur me kërkesën e subjektit për marrje provash, është arsyetuar dhe i është njoftuar rregullisht subjektit të rivlerësimit⁹. Gjithashtu, rezultoi se edhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë për marrje provash me ekspertë vlerësues pasurish, së bashku me kërkesën për riçeljen e hetimit administrativ për dy kriteret e tjera të rivlerësimit. Kjo kërkesë, me vendim të ndërmjetëm të Komisionit, është rrëzuar dhe arsyet e mospranimit të saj janë arsyetuar edhe në vendimin përfundimtar të Komisionit. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se procedura e ndjekur nga ana e Komisionit në trajtimin e kërkesave të subjektit për marrjen e provave, rezulton të jetë kryer në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk u konstatuan shkelje të natyrës procedurale, të cilat mund të përbënin cenim të së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor.
26. Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit sjellja e trupit gjykues të Komisionit nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme me pasojë cenimin e procesit të rregullt ligjor, duke qenë se i njëjti trup gjykues i Komisionit ka kryer hetimin administrativ në lidhje me pasurinë, ka çmuar provat dhe më pas ka marrë vendimin lidhur me rivlerësimin kalimtar të tij, trupi gjykues çmon se ky pretendim është i pabazuar në ligj, për sa kohë veprimtaria e trupit gjykues të Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017. Gjithashtu në çështjen gjyqësore Xhoxhaj kundër Shqipërisë, për pretendime të njëjta të kërkuases me sa më sipër¹⁰, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vlerësuar se nuk ka shkelje të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së në drejtim të parimit të gjykatës së paanshme¹¹.
27. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjen të pabazuar në fakte dhe në ligj edhe shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës së tij për proces të rregullt ligjor, bazuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNj-së.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material.

28. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme “ndërtesë 3 kate + bodrum”, me sipërfaqe trualli 229,95 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 348,15 m², në Kukës, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuara konkluzionet e Komisionit për deklarim të pasaktë, deklarim të rremë, fshehje të pasurisë dhe mungesë burimesh të ligjshme në lidhje me ndërtimin e kësaj pasurie, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*

⁹ Njëpërmjet shkresës së Komisionit nr. {***} prot., datë 29.10.2019.

¹⁰ Shih paragrafin 230 të vendimit të GjEDNj-së Xhoxhaj kundër Shqipërisë.

¹¹ Shih paragrafët 307, 308 dhe 317 të të njëjtit vendim të GjEDNj-së.

29. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me analizën e kryer mbi krijimin e kësaj pasurie, ndër të tjera, si vijon: *Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe rrethanave sa më sipër arsyetuar, në raport me prapësimet e subjektit në rezultatet e hetimit administrativ, mban në vëmendje përmbushjen në mënyrë kumulative të elementeve ligjore në kuptim të ligjit nr. 84/2016: (a) vërtetësinë e deklarimeve; (b) burimin e ligjshëm të mbështetur në dokumentacion provues, për të cilat pas përlllogaritjeve financiare të pasqyruara në tabelën nr. 3¹², subjekti rezultoi në pamjaftueshmëri financiare të burimit të ligjshëm për këtë pasuri dhe për këtë shkak, çmon se: i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, lidhur me kohën e ndërtimit të pasurisë objekt hetimi administrativ, pasi nuk e ka deklaruar ndërtimin e kësaj pasurie vit pas viti, minimalisht, siç e ka deklaruar gjatë hetimit administrativ, se në vitin 2003 kishte përfunduar bodrumi dhe kati i parë, dhe nuk ka deklaruar saktësisht përfundimin e këtij ndërtimi në vitin 2005, sikurse ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të depozituar tek ALUIZNI. ii. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë lidhur me vlerën reale të shpenzuar për ndërtimin e kësaj pasurie. iii. Subjekti është në mungesë burimesh financiare në vlerën 5.220.152 lekë për ndërtimin e kësaj pasurie, si dhe për të kryer shpenzime të tjera familjare.*
30. Lidhur me vlerësimin e Komisionit për këtë pasuri të paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit Isuf Shehu, ky i fundit ka ngritur shkaqet e mëposhtme në ankimin e tij.

30.1. Subjekti kundërshtoi si të gabuara konkluzionet e Komisionit për deklaram të pasaktë, deklaram të rremë dhe mungesë të burimeve të ligjshme për ndërtimin e pasurisë objekt gjykimi, duke qenë se:

- a) Ndaj tij nuk ka nisur asnjëherë ndonjë procedurë administrative apo procedim penal që lidhet me problematika në deklarimin e pasurive pranë ILDKPKI-së.
- b) Me deklarimin e vlerës së preventivit të lejes së ndërtimit si vlerë të objektit nuk ka kryer deklaram të rremë, sa kohë: (i) ky preventiv është pjesë e aktit administrativ me të cilin janë miratuar kondicionet urbanistike të ndërtesës; (ii) vetë certifikata e pronësisë nuk ka vlerë të pasurisë në fjalë dhe nuk rezulton që kjo pasuri të jetë vlerësuar; (iii) vlera prej 10.528.056 lekësh, e përcaktuar nga ALUIZNI në vitin 2012, nuk përfaqëson vlerën reale të ndërtimit, pasi ajo është përcaktuar nga ALUIZNI sipas kostos së ndërtimit të EKB-së në momentin e legalizimit të ndërtesës, me qëllim përcaktimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe se kjo vlerë e përcaktuar si vlerë e objektit nuk i është bërë me dije subjektit.
- c) Ai ka vetëm një banesë, e cila është ndërtuar në truallin për të cilin është marrë leja për shesh ndërtimi në vitin 1996 dhe se nuk ka banesë tjetër, për rrjedhojë nuk ka kryer fshehje pasurie. Sipas subjektit, ky fakt është i provuar edhe nga aktet shkresore të OSHEE-së dhe Ujësjetllës Kanalizimeve, nga të cilat rezulton se në emër të tij është lidhur vetëm një kontratë furnizimi.
- ç) Konkluzioni i Komisionit në vendim se nuk ka kërkesë të subjektit të rivlerësimit lidhur me aplikimin për ripërsëritje të lejes së ndërtimit, është në kundërshtim me provat e depozituara në seancë gjyqësore duke iu referuar këtu një kërkesë të tij të datës 10.03.2000, drejtuar Këshillit të Rregullimit të Territorit, Kukës, sipas së cilës pretendoi se ka bërë kërkesë për miratimin e një leje të re ndërtimi, pasi leja e parë e ndërtimit e cila nuk ishte zbatuar nga ana e subjektit të rivlerësimit, ishte lëshuar sipas ligjit të mëparshëm nr. 7693, datë 06.04.1993, “Për urbanistikën”, ndërkohë që tashmë kishte hyrë në fuqi ligji nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për urbanistikën”. Për rrjedhojë, sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi nr. 48, datë 10.05.2000, “Për miratimin e kondicioneve urbanistike për objektin lokal + banesë në lagjen nr. {***}, Kukës”, është miratuar në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit.

¹² I referohet “Tabelës nr. 3” në faqet 10 dhe 11 të vendimit të Komisionit.

30.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë përlogaritjen e vlerës së ndërtimit nga ana e Komisionit dhe shpërndarjen e kostos ndër vite, si pasojë e pretendimeve në lidhje me vitin e përfundimit të ndërtimit. Në mbështetje të këtij shkakut të ankimit sa i takon vitin e përfundimit të ndërtimit të objektit 3-katësh, subjekti pretendoi se marrja si e mirëqenë e faktit se në deklaratën e përfshirjes në procedurat e legalizimit, objekti është deklaruar se ka përfunduar në vitin 2005, është e pambështetur pasi: (i) paraqitja e kërkesës për legalizim të objektit pranë ALUIZNI-t, më datë 12.09.2006, është bërë për arsye procedurale të afateve (referuar ndryshimeve ligjore, pasi shtëpia ishte në ndërtim e sipër); (ii) sipas dokumenteve, provohet fakti se objekti është legalizuar përfundimisht në vitin 2012, fakt që tregon përfundimin e objektit në vitin 2010; (iii) në deklaratat vjetore pranë ILDKPKI-së pas vitit 2005, subjekti pretendoi se objekti është deklaruar në ndërtim e sipër deri në vitin 2010.

31. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, duke marrë në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin e Komisionit dhe arsyetimin e këtij të fundit në vendim, trupi gjykues konstatoi se pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, janë të njëjta me sa pretenduar dhe shpjeguar prej tij para Komisionit, në kundërshtim të rezultateve të hetimit. Konstatohet se Komisioni në pjesën arsyetuese të vendimit, lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie në pronësi të subjektit të rivlerësimit, i ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të tij dhe se, kundërshtimet e subjektit në Kolegj nuk sjellin asgjë të re në këtë drejtim. Megjithatë, trupi gjykues lidhur me shkaqet e ankimit mbi kundërshtimin e vlerësimit të pasurisë objekt kontrolli, në dallim nga Komisioni, gjen me vend të parashtrorë sa më poshtë vijon.

31.1. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ai nuk ndodhet në kushtet e deklarimit të rremë, deklarimit të pasaktë dhe mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe se ky fakt provohet sipas tij me mungesën e ndonjë procedimi administrativ apo fillimin e ndonjë procedimi penal lidhur me çështje që kanë të bëjnë me deklarimin e pasurive, trupi gjykues e gjen të pabazuar në ligj një pretendim të tillë. Referuar legjislacionit të zbatueshëm lidhur me procesin e rivlerësimit, konkretisht Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve është një proces i ri, i cili bazohet në vlerësimin dhe kontrollin e pasurive të subjekteve të rivlerësimit të deklaruara rishtas dhe vlerësimi i saktësisë, plotësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimit të tyre kryhet nga organet e rivlerësimit mbi bazën e një procesi të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe, si i tillë, nuk bazohet në përfundimet e organeve që kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale në proces¹³ (një ndër to dhe ILDKPKI), aq më pak të jenë të detyruara të mbështeten në vlerësimin apo qëndrimin e tyre ndaj subjekteve në deklarimet e tyre ndër vite. Për rrjedhojë të sa më sipër, fakti nëse ILDKPKI-ja ka kryer apo jo kontrole të plota lidhur me pasurinë e subjektit të rivlerësimit dhe se nuk ka nisur ndonjë procedurë administrative, apo ndaj tij rezulton të mos jetë nisur një procedim penal për problematika në lidhje me deklarimet e pasurisë dhe interesave privatë të tij, nuk ka relevancë mbi vlerësimin e organeve kushtetuese të mandatuara për të kryer këtë proces rivlerësimi kalimtar sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016.

31.2. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruar më sipër, lidhur me kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit për deklarim të rremë të vlerës së objektit “3 kate + bodrum”, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën e vlerës së pasurisë si vijon: *Vlera e legalizimit është 462.590 (katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) lekë.*

¹³ Referojuni vendimit nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese, parag. 40, 41.

Banesa është e pavlerësuar. Në bazë të preventivit të vitit 2000, vlera është 2.201.472 (dy milionë e dyqind e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë. Ndërsa në deklaratën për herë të parë pranë ILDKPKI-së, të dorëzuar në mars të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar objektin “në ndërtim e sipër” dhe në rubrikën e vlerës ka deklaruar “2 (milionë) lekë”.

31.3. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, konstatohet se: (a) në kartelën e pasurisë së paluajtshme, është shënuar vlera 462.590 lekë që i korrespondon pagesës së kryer nga subjekti i rivlerësimit pranë ALUIZNI-t me qëllim legalizimin e ndërtimit banesë 3 kate + bodrum; (b) vlera e investimit për efekt të përcaktimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas ALUIZNI-t, është përlogaritur në masën e 10.528.056 lekëve, si prodhim i sipërfaqes së ndërtimit 348,15 m² dhe çmimit/m² në vlerën e 30.240 lekëve. Ndërkohë, si pjesë të praktikës së lejes së ndërtimit nr. 48, datë 10.05.2000, subjekti ka dorëzuar edhe një preventiv “Objekti Lokal + Banesë e z. Isuf Shehu, në lagjen nr. {***} Kukës” me vlerë 2.201.472 lekë. Nga verifikimet e kryera në aktet e fashikullit të çështjes, nuk rezultoi që ky preventiv të jetë administruar nga organet shtetërore përkatëse si dokumentacion i cili të ketë lidhje me objektin në fjalë. Gjithashtu, nga hetimi administrativ i Komisionit, nuk ka rezultuar asnjë dokumentacion i cili të provojë se sa ka qenë realisht kostoja e ndërtimit të kësaj ndërtese “3-katëshe + bodrum”.

31.4. Në përgjigje të pyetjeve të Komisionit sipas pyetësorit të dërguar me *e-mail* më datë 31.07.2019, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Duke mos pasur dokumentacion për shpenzimet e bëra për ndërtimin e kësaj banese sipas viteve, i jam drejtuar një eksperti ndërtimi të licencuar, për të përpiluar preventivin e shpenzimeve të ndërtimit të banesës. [...] Në total, sipas ekspertit të licencuar, kostoja e ndërtimit të banesës, referuar çmimeve të punimeve të përcaktuara në preventivin e lejes së ndërtimit, ka vlerën totale 3.763.097 lekë. Së bashku me përgjigjet e tij, subjekti ka përcjellë pranë Komisionit “Relacionin shpjegues të ekspertit, ing. D. D., me nr. licence {***}, si dhe preventivat e punimeve sipas fazave”.*

- 32.** Nga vlerësimi i fakteve që lidhen me ndërtimin e kësaj pasurie dhe nga interpretimi logjik i tyre, trupi gjykues arrin në konkluzionin që preventivi i përgatitur nga ing. Xh. N. nuk përfaqëson preventivin e punimeve të ndërtesës objekt kontrolli, duke qenë se ky preventiv i takon një tjetër objekti në kuptim të projektit arkitekturor. Për rrjedhojë, edhe vlera e tij, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, jo vetëm që nuk është vlera e shpenzuar për ndërtimin e këtij objekti, por as që përfaqëson një të dhënë relevante në drejtim të kostos së ndërtimit të tij, në kushtet kur më së paku volumet e punimeve janë të ndryshme.
- 33.** Ndërkohë, vlera prej 10.528.056 lekësh, e përcaktuar si vlerë investimi në “Formularin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale” të ALUIZNI-t, referuar parashikimeve të pikës 3.1¹⁴ të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1180, datë 05.08.2008, “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit”, është një vlerë e llogaritur sipas formulës së përcaktuar në aktin nënligjor, për efekt të përcaktimit të nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe nuk përfaqëson ndonjë përlogaritje të vlerës së investimit të kryer. Në këtë kuptim, edhe kjo e dhënë

¹⁴ Pika 3.1 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1180, datë 05.08.2008, “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit” përcakton: Taksa e ndikimit në infrastrukturë llogaritet duke iu referuar kostos mesatare vjetore të ndërtimit të banesave për m², publikuar nga Enti Kombëtar i Banesave, në kohën e llogaritjes, në përputhje me pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 9416, datë 20.05.2005, “Për procedurat e privatizimit të banesave, të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave”.

e administruar gjatë hetimit administrativ, nuk mund të merret si e dhënë zyrtare që provon vlerën e investimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit.

34. Në këto kushte, edhe pse subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën e vlerës së pasurisë ka deklaruar vlerën e preventivit sipas lejes së ndërtimit të vitit 2000, e cila nuk përfaqëson vlerën e shpenzuar prej tij (veprim ky i cili mundet edhe të jetë i qëllimshëm në drejtim të fshehjes prej tij të vlerës reale të shpenzuar), ky fakt vlerësohet nga ana e trupit gjykues i pamjaftueshëm për t'u kualifikuar si deklarim i rremë, duke qenë se (i) subjekti e ka specifikuar në deklaratën e pasurisë *vetting* që kjo është vlera sipas preventivit; (ii) ka sqaruar gjatë procedurës së hetimit në Komision se nuk ka dokumentacion provues të shpenzimit të kryer dhe nuk ka deklaruar se shpenzimi i kryer ka qenë në vlerë sa vlera e preventivit; dhe se (iii) në fashikull nuk rezulton të jetë administruar asnjë provë e vlerës së saktë të shpenzuar (situacione punimesh, fatura tatimore) apo kontraktuar (çmim kontraktual sipërmarrjeje) nga subjekti për kryerjen e ndërtimit në fjalë.
35. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, referuar gjendjes së fakteve dhe rrethanave si më sipër konstatuar, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë, në përputhje me ligjin, pasurinë e sipërcituar në deklaratën e pasurisë *vetting*, por pavarësisht kësaj, vlerësimi i Komisionit për deklarim të rremë nuk qëndron. Trupi gjykues çmon se Komisioni që të mund të arrinte në konkluzionin nëse ndodhej para faktit të një deklarimi të rremë të vlerës së investuar nga subjekti i rivlerësimit për ndërtimin e objektit 3-katësh, nevojitej të kishte provë të vlerës së shpenzuar, me qëllim krahasimin e kësaj vlere me vlerën e deklaruar nga ana e subjektit. Në kushtet e mosadministrimit të një prove të tillë, konkluzioni i Komisionit për deklarim të rremë të vlerës së investuar për ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli, “ndërtesa 3 kate + bodrum”, gjendet nga trupi gjykues i pabazuar në fakte.
36. Në lidhje me kundërshtimin e subjektit të rivlerësimit se ai nuk ka kryer fshehje pasurie dhe se sipas tij ky fakt është i provuar, pasi ai ka vetëm një banesë, e cila është ndërtuar në truallin për të cilin është marrë leja për shesh ndërtimi në vitin 1996 dhe se nuk ka banesë tjetër, trupi gjykues konstatoi se konkluzionet e arritura nga Komisioni, pas kontrollit të kryer lidhur me krijimin e kësaj pasurie, konsistojnë në: (i) deklarim të pasaktë lidhur me kohën e ndërtimit të pasurisë; (ii) deklarim të rremë lidhur me vlerën reale të shpenzuar për ndërtimin e kësaj pasurie; dhe (iii) mungesë burimesh financiare për ndërtimin e kësaj pasurie¹⁵. Referuar sa më lart, vihet re që Komisioni nuk ka arritur në përfundimin se subjekti në rastin në fjalë të ketë kryer fshehje të pasurisë. Me sa kuptohet, subjekti në ankimin e tij ka kundërshtuar konstatimin e ILDKPKI-së, të referuar edhe në vendimin e Komisionit, sipas të cilit subjekti ka kryer fshehje të banesës 3 kate + bodrum në Kukës në deklaratat e interesave privatë ndër vite, si dhe në deklaratën “*vetting*”.
37. Për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit e gjen pa efekt në zgjidhjen e çështjes nga ana e Kolegjit, pasi ai nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vendimit të Komisionit, për sa kohë i referohet një konkluzioni të arritur nga ana e ILDKPKI-së, i cili nuk është konfirmuar nga Komisioni në vendimin e tij.
38. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit të parashtruar më sipër në vendim, sipas të cilit konkluzioni i Komisionit se nuk ka kërkesë të subjektit të rivlerësimit lidhur me aplikimin për ripërsëritje të lejes së ndërtimit, është konkluzion në kundërshtim me provat e depozituara në seancë gjyqësore, duke iu referuar këtu një kërkesë të tij të datës 10.03.2000, drejtuar Këshillit të Rregullimit të Territorit, Kukës, trupi gjykues konstatoi se në vendim ky “konkluzion” referohet

¹⁵ Shih faqen 18 të vendimit të Komisionit.

si një nga faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni. Pavarësisht kësaj, nga shqyrtimi i pjesës arsyetuese të vendimit, nuk rezultoi që Komisioni t'i ketë dhënë ndonjë peshë specifike këtij fakti dhe të ketë arritur në ndonjë konkluzion konkret lidhur me çështjet të cilat janë përcaktuese në vlerësimin e kësaj pasurie. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit çmohet nga trupi gjykues pa efekt në vlerësimin e bazueshmërisë së vendimit të Komisionit lidhur me pasurinë objekt kontrolli.

39. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit i cili lidhet me kundërshtimin e mënyrës së përlllogaritjes nga Komisioni të vlerës së ndërtimit të “ndërtesës 3-katëshe + bodrum”, me vendndodhje në lagjen nr. {***}, Kukës dhe shpërndarjes së kostos së tij ndër vite, trupi gjykues çmon se fillimisht analiza juridike lidhur me këtë shkak ankimi duhet të fokusohet në përcaktimin e vitit të përfundimit të ndërtimit dhe mbi bazën e kësaj të dhëne, të vlerësohet edhe analiza e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për financimin e ndërtimit të tij.
40. Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se qëndrimi i Komisionit në lidhje me vitin e përfundimit, është kontradiktor dhe shprehet konkretisht: *KPK-ja pranon si vit të llogaritjes së kostos së ndërtimit atë të vitit 2012, kur është miratuar leja e legalizimit, ndërkohë vetë pranon se objekti ka përfunduar në vitin 2005 dhe, bazuar në vitin e përfundimit të objektit në vitin 2005, ka llogaritur vlerën e investimit dhe nëse kjo vlerë investimi kishte burime të ligjshme deri në vitin 2005, edhe pse e merr koston e ndërtimit në vitin 2011. Atëherë duhej që ALUIZNI të kishte llogaritur taksën e ndikimit në infrastrukturë me koston e ndërtimit në vitin 2005, por nuk e ka llogaritur të tillë sepse ka verifikuar që objekti ka mbaruar më vonë. Në këto kushte, edhe KPK-ja duhej ta kishte ndarë investimin deri në vitin 2012, kur është miratuar leja e legalizimit dhe jo deri në vitin 2005.*
41. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu kundërshtoi qëndrimin e Komisionit lidhur me trajtimin e vitit 2005 si vit të përfundimit të ndërtimit nga subjekti të pasurisë objekt kontrolli, me argumentin se Komisioni bazohet vetëm në një shkresë të thjeshtë (duke iu referuar këtu formularit të vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t), e cila kundërshtohet nga vetë përpiluesi.
42. Në kuadër të shqyrtimit të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit para trupit gjykues ngrihen për diskutim dhe analizë çështjet si më poshtë:
 - Ka qenë apo jo Komisioni kontradiktor në drejtim të përcaktimit të vitit të përfundimit të ndërtimit të objektit 3-katësh për efekt të përlllogaritjes së vlerës së tij?
 - Është apo jo tregues në drejtim të vitit të përfundimit të objektit, vlerësimi që i ka bërë ALUIZNI vlerës së investimit të kryer për ndërtesën “3 kate + bodrum”, objekt legalizimi?
 - A është i bazuar në fakte konkluzioni i Komisionit për përcaktimin e vitit 2005 si vit të përfundimit të ndërtimit?
43. Lidhur me çështjen e parë, nëse Komisioni ka qenë apo jo kontradiktor në përcaktimin e periudhës kohore gjatë së cilës është realizuar ndërtimi i objektit 3-katësh, me qëllim përcaktimin e vlerës së ndërtimit bazuar në përlllogaritjen e kostos së ndërtimit sipas vlerave të EKB-së, referuar çmimeve sipas viteve të ndërtimit, trupi gjykues konstatoi se Komisioni në pjesën “Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ”, në paragrafin 1.11.ii, në faqen 9 të vendimit shprehet: *Komisioni sikurse është shprehur më sipër, është bazuar në kostot e EKB-së, për shkak se subjekti nuk ka mundur të depozitojë situacione ndërtimi dhe fatura, si dhe relacioni i inxhinierit nuk është kryer me çmimet reale të periudhës, por me çmimet e preventivit të vitit 1996.*

44. Ndërkohë në tabelën nr. 1, në faqen nr. 10 të vendimit, Komisioni ka paraqitur përshkrimin e punëve dhe sipërfaqet e ndërtuara sipas harkut kohor 2000-2003 dhe 2004-2005. Ndërsa në paragrafin 1.11.iii, Komisioni ka parashtruar se në analizën financiare, sipërfaqet e ndërtimit të kryera në secilin hark kohor i ka ndarë në mënyrë të barabartë, në vitet e përfshira dhe se këto sipërfaqe i ka shumëzuar me kostot e ndërtimit sipas EKB-së për secilin vit, me qëllim nxjerrjen e kostos totale të investimit të kësaj pasurie. Trupi gjykues konstatoi se sa më sipër, Komisioni e ka konkretizuar në tabelën nr. 2, më poshtë në të njëjtën faqe të vendimit ku ka bërë ndarjet e sipërfaqeve të ndërtuara për çdo vit në periudhën e vlerësimit 2000-2005, përcaktimin e kostove për sipërfaqe ndërtimi sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave për secilin vit dhe vlerat përkatëse të investimit. Në lidhje me sa më sipër, trupi gjykues, nga verifikimi i kryer në legjislacionin e referuar nga ana e Komisionit, konstatoi se vlerat e përcaktuara në tabelën nr. 2 nga Komisioni, të cilat u takojnë çmimeve për sipërfaqe ndërtimi për vitet nga 2000-2005, janë të sakta.
45. Në pjesën arsyetuese të vendimit të Komisionit, në faqen nr. 16 të tij, Komisioni pasi ka parashtruar edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, ka arsyetuar përfundimisht: *Në këto kushte, trupi gjykues ka gjetur me vend kryerjen e analizës financiare bazuar në kostot e Entit Kombëtar të Banesave për ndërtimin e kësaj pasurie, nga ku ka rezultuar se subjekti gjendet në pamundësi financiare në vlerën 5.220.152 lekë, për të mundësuar ndërtimin e kësaj pasurie. Ky vlerësim i Komisionit është bazuar në legjislacionin që i referohet kohës në të cilën është bërë ndërtimi 2000-2005, duke realizuar përllogaritje të sakta dhe të plota për çdo vit ndërtimi.*
46. Për rrjedhojë, në lidhje me çështjen e parë për diskutim, trupi gjykues, në analizë të sa më sipër konstatuar, arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni është kontradiktor në vlerësimin e vlerës së pasurisë se ndërkohë që pranon se ndërtimi ka përfunduar në vitin 2005, përllogaritjet i ka bërë mbi bazën e çmimeve të EKB-së së vitit 2011, është tërësisht i pabazuar në fakte.
47. Lidhur me çështjen e dytë për diskutim, nëse është apo jo tregues në drejtim të vitit të përfundimit të objektit, vlerësimi që i ka bërë ALUIZNI vlerës së investimit të kryer për ndërtesën “3 kate + bodrum”, në një ndër formularët e procesit të legalizimit të objektit, konkretisht atij të përcaktimit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale, trupi gjykues, pasi verifikoi legjislacionin e zbatueshëm në kohën e lëshimit të këtij formulari, konstatoi si më poshtë.
- 47.1. Referuar nenit 23 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar deri në kohën që është lëshuar formulari objekt vlerësimi, taksë vendore e ndikimit në infrastrukturë zbatohet në kufirin minimal, të përcaktuar për njësinë vendore përkatëse, sipas pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr. 8982, datë 12.12.2002, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar¹⁶. Sipas parashikimit të nenit 27, pika 2/1 e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, taksë e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, është 0,5 për qind e vlerës së investimit.
- 47.2. Në kuptim të sa më sipër, vlera e investimit për efekt të përcaktimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja në proces legalizimi përcaktohet sipas rregullave të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1180, datë 05.08.2008 “Për përcaktimin e vlerës së tarifës

¹⁶ Saktësohet se ligji nr. 8982, datë 12.12.2002, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar është shfuqizuar me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”. Për rrjedhojë, mënyra e përcaktimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja do të bëhet sipas dispozitave të këtij ligji.

së shërbimit për legalizimin dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit”. Referuar pikës 3.1 të këtij vendimi, vlera e investimit përlllogaritet duke iu referuar koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave për metër katror, publikuar nga Enti Kombëtar i Banesave në kohën e llogaritjes.

48. Për rrjedhojë, aplikimi në vitin 2011 i çmimit për metër katror sipërfaqeje ndërtimi të publikuar nga EKB-ja, në fuqi në kohën e llogaritjes, nuk është tregues i faktit se ndërtimi ka përfunduar në atë periudhë, por thjesht dëshmon zbatimin e përpiktë të parashikimit nënligjor mbi bazën e të cilit do të përlllogaritej vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet në proces legalizimi. Për pasojë, trupi gjykues e gjen të pabazuar në ligj pretendimin e subjektit se përlllogaritja e vlerës së investimit nga ALUIZNI, sipas vlerave të EKB-së për vitin 2011, është tregues në drejtim të vitit të përfundimit të ndërtimit të objektit në procedurë legalizimi.
49. Sa i takon çështjes së fundit të ngritur për diskutim, nëse ishte apo jo i bazuar në fakte konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e vitit 2005, si vit i përfundimit të ndërtimit të objektit, trupi gjykues konstatoi se Komisioni e ka bazuar këtë konkluzion në të dhënat e administruara nga formulari i vetëdeklarimit të objektit për legalizim, fotove të dorëzuara prej tij lidhur me gjendjen e objektit në momentin e vetëdeklarimit dhe atyre që pasqyrojnë gjendjen e këtij objekti gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, të dhënave nga OShEE-ja lidhur me kohën e lidhjes së kontratës së furnizimit me energji elektrike, si dhe deklarimeve periodike pranë ILDKPKI-së lidhur me objektin në fjalë.
50. Në kuadër të verifikimit të këtyre fakteve që kanë shërbyer për arritjen në konkluzionin e Komisionit se ndërtimi i objektit me “3 kate + bodrum” kishte përfunduar në vitin 2005, trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit, konstatoi si më poshtë.

50.1. Në deklaratën për herë të parë pranë ILDKPKI-së, dorëzuar në mars të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Objekti i përshkruar më lart është në ndërtim e sipër, pa përfunduar*. Në DIPPV-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar: *Shtëpi banimi e papërfunduar sipas lejes së banimit nr. {***}, dt. 10.05.2000*. Në DIPPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *Objekti shtëpi banimi e ndërtuar sipas lejes së ndërtimit (KRRT Kukës) me nr. {***}, datë 10.05.2000, e paregjistruar dhe e deklaruar më parë e kam futur në procedurat e legalizimit, për faktin se lejes së ndërtimit i ka kaluar afati ligjor për regjistrim të objektit*. Në DIPPV-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Më datën 10.05.2012, kam marrë lejen e legalizimit nr. {***} dhe certifikatën e pronësisë nr. {***}, vol. {***}, faqe {***}, lëshuar nga ZVRPP Kukës, më datë 26.11.2002 (shtëpi banimi), lagje nr. {***} (Kukës, me sip. 290 m² truall, nga këto 109 sip. ndërtimore (banesë)). Sa më sipër konstatuar hedh poshtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, të shprehur në paragrafin 73 të ankimit të tij se: *Në deklaratat periodike/vjetore, ashtu siç kemi përmendur më sipër, çdo vit nga viti 2003 e në vijim, për çdo vit është deklaruar “në vazhdim të punimeve” deri në marrjen e lejes së legalizimit, kjo ka qenë arsyeja për të cilën nuk kam deklaruar likuiditete dhe nuk kam pasur gjendje lek, për shkak se i kam investuar në mënyrë të vazhdueshme tek kjo ndërtesë të gjitha kursimet e punës sonë*.*

50.2. Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 17.10.2019, OShEE-ja, në përgjigje të kërkesës për informacion nga ana e subjektit të rivlerësimit, është shprehur: *Me gjeneralitetet Isuf H. Shehu, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet 1 (një) abonent me kontratën e furnizimit me nr. {***} në instancën Kukës, e hapur më datë 31.12.2005*. Gjithashtu, vetë subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore ka pohuar se ka lidhur kontratën për furnizimin me energji elektrike diku rreth viteve 2004 – 2005. Bie në sy gjithashtu fakti se në DIPPV-në e vitit 2006 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi “shtëpi private, lagjja nr. {***}, Kukës”

krahasuar me adresën e deklaruar në DIPPV-në e mëparshme të vitit 2005, ku kishte deklaruar “Lgj. nr. {***}, pll. {***}, Kukës”. Trupi gjykues çmon se sa më sipër hedh poshtë gjithashtu pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se përfshirja në procesin e legalizimit të këtij ndërtimi në vitin 2006, është bërë në fazën e karabinasë.

50.3. Referuar formularit të vetëdeklarimit të dorëzuar pranë ALUIZNI-t nga ana e subjektit të rivlerësimit më datë 12.09.2006, ky i fundit, në përgjigje të rubrikave që identifikojnë objektin për legalizim, ka deklaruar: *Shtëpi banimi, 3 kate, viti i ndërtimit 2005. Numri i kateve nën tokë 1, numri i kateve mbi tokë 3, lartësia e përgjithshme e objektit 11 m, vëllimi i objektit 1280 m³, mure rrethuese 92 m.* Në “Manualin e procedurave mbi procesin e vetëdeklarimit”, miratuar me urdhrin nr. 46, datë 18.07.2006, të ministrit të fushës, në pikën 2.1 të tij, sa i takon objektit të këtij procesi vetëdeklarimi përcaktohet: *Deklarohet nëpërmjet formularit “Vetëdeklarim për legalizimin e objektit - Shtojca A” e ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, objekti që ka të realizuar minimalisht konstruksionin e një kati me lartësi dysHEME - tavan jo më pak 2 m dhe ka të përfunduar mbulesën.* Ndërkohë në pikën 3 të këtij urdhri përcaktohet shprehimisht: *3.1 Rubrikat e formularit duhet të plotësohen në mënyrë të saktë dhe të plotë. Plotësimi i formularit duhet të konsiderohet si një moment i rëndësishëm nga ku merren të dhënat bazë për ndërtimin pa leje, që do të shërbejnë për ecurinë e procesit deri në pajisjen me lejen e legalizimit dhe regjistrimin e objektit në ZRPP. [...] 3.5 Në rubrikën “Viti i ndërtimit” të shënohet viti i përfundimit të ndërtimit të objektit.* Referuar këtyre parashikimeve nënligjore të kohës, subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte gjendjen e saktë të objektit të ndërtuar, i cili më pas do t’i nënshtrohej procedurës së verifikimit në terren nga strukturat përgjegjëse të njësisë përkatëse vendore, me qëllim kualifikimin apo jo si objekt që legalizohet, sipas kushteve dhe kritereve të miratuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 28.06.2006, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo”¹⁷.

50.4. Subjekti i rivlerësimit, këtë formular, bazuar në kërkesat e akteve nënligjore të zbatueshme, e ka shoqëruar me certifikatën e gjendjes familjare dhe fotografi të katër pamjeve të objektit. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i këtyre fotove dhe krahasimi i tyre me fotot e objektit, të depozituara gjatë hetimit administrativ në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, të cilat tregonin gjendjen në atë moment të ndërtesës, vëren se fotot edhe pse i referohen gjendjes fizike të ndërtesës në periudha të ndryshme kohore, nuk paraqesin dallime mes tyre. Objekti në momentin e deklarimit në vitin 2006, duket pothuajse i njëjtë me objektin në kohën e kryerjes së hetimit administrativ gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar në vitin 2019.

- 51.** Në vlerësim të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni me të drejtë ka arsytuar: *[...] trupi gjykues analizoi formularin e vetëdeklarimit të subjektit si akti i parë i depozituar në çdo dosje të aplikimit për legalizimin e ndërtimeve informale. Nga verifikimi i këtij formulari, u konstatua se subjekti kishte deklaruar ndërtimin e këtij objekti në lartësinë tri kate,*

¹⁷ Në pikën 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 28.06.2006, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo”, përcaktohet:

“5. Për kualifikimin e objekteve që legalizohen apo jo, veprohet si më poshtë vijon:

a) Identifikohet nga njësia e qeverisjes vendore, me pranimin e formularit të vetëdeklarimit, ndërtimi në hartë/fotografi, gjendja ndërtimore, sipas vendndodhjes.

b) Verifikohet në terren nga njësia e qeverisjes vendore, brenda 20 ditëve nga dorëzimi i formularit të vetëdeklarimit, ndërtimi i identifikuar në hartë/fotografi dhe hartohet procesverbali i konstatimit”.

me sip. 500 m², në vitin 2005. Trupi gjykues vlerësoi pretendimin e subjektit se ky formular është dokumenti i parë i domosdoshëm për nisjen e një procedure legalizimi, por që nuk trajtohet si i vetmi dokument, pasi sipas kësaj logjike të pranueshme edhe për trupin gjykues, ai shoqërohet edhe me dokumente të tjera. Trupi gjykues e gjen me vend këtë pretendim të subjektit, por duke vërejtur dokumentacionin bashkëlidhur dhe më konkretisht fotot e paraqitura në praktikën e ALUIZNI-t me fotot e depozituara nga vetë subjekti në korrespondencën e mbajtur me Komisionin, konstaton se vizualisht pamjet e ndërtimit, lartësia, kondicionet urbane etj., janë të njëjta dhe përkojnë plotësisht dhe identifikojnë të njëjtin ndërtim në parametra, çka bën të kuptohet se në kohën e vetëdeklarimit, subjekti ka pasqyruar gjendjen reale dhe fizike të objektit, ka plotësuar të dhëna të sakta, të vërteta, në dijeni të plotë të ligjit, madje me vullnet të lirë dhe po ashtu sikurse kërkohet, ka nënshkruar. [...] Gjithashtu, fakti që furnizimi me energji elektrike për këtë pasuri kishte filluar në vitet 2004 - 2005, sipas deklarimit të subjektit në seancë dëgjimore, vlerësohet si një tjetër provë përforcuese që tregon ndërtimin dhe funksionimin e kësaj pasurie prej vitit 2005. Po ashtu, në tërësinë e provueshmërisë së fakteve se ndërtimi është kryer gjatë viteve 2000 – 2005, përfshihet edhe fakti që subjekti nuk ka vijuar të deklarojë në deklaratën periodike për vitin 2006 lidhur me fazën e ndërtimit të objektit, konstatim ky që bën të besueshëm përfundimin dhe ndërtimin e objektit në vitin 2005.

52. Në kuadër të analizës së kryer lidhur me këtë shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e gjen të bazuar në fakte konkluzionin e arritur nga ana e Komisionit lidhur me përcaktimin e vitit të përfundimit të ndërtimit të pasurisë objekt kontrolli. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e sa dëshmojnë faktet e administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe shkaqet e ngritura në ankimin e tij nuk u gjetën të bazuara në fakte dhe në ligj, dhe për pasojë nuk arritën të bëjnë të cënueshëm konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, si më sipër parashtruar.
53. Gjithashtu, trupi gjykues, në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues lidhur me vlerën e investimit të kryer për ndërtimin e objektit “3 kate + bodrum”, si dhe në mungesë të deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të vlerës së shpenzuar/investuar në krijimin e pasurisë objekt kontrolli, gjen të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit për mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së ndërtimit mbi bazë analize të kostos së objektit sipas çmimit për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit, sipas çmimeve mesatare të ndërtimeve nga EKB-ja. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit në parashtrimet e tij para Kolegjit, se vlerës së objektit të përcaktuar sipas kostos për m² sipërfaqeje ndërtimi, sipas çmimeve të EKB-së, duhet t’i zbriten kostoja e materialeve të ndërtimit, kostoja e krahut të punës dhe vlera e fitimit të subjektit ndërtues duke qenë se ndërtimi, sipas subjektit të rivlerësimit, është kryer me kontribut vullnetar të familjarëve dhe jo nga kompani sipërmarrëse, si dhe me materiale ndërtimi të siguruara në tregun informal, trupi gjykues i gjeti këto pretendime të pabazuara në fakte, sa kohë subjekti nuk arriti të provojë se kostoja e materialeve të ndërtimit dhe krahu i punës i përdorur për ndërtimin e objektit i kanë kushtuar atij më lirë sesa pjesa takuese e kostos sipas çmimeve të EKB-së.
54. Trupi gjykues vlerësoi gjithashtu të pabazuar në ligj edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni gabimisht ka përlllogaritur sipërfaqet ndihmëse (ballkonet) me vlerën e sipërfaqeve të banimit, pasi sipas tij, referuar akteve nënligjore të urbanistikës, sipërfaqet ndihmëse llogariten me ½ e vlerës së sipërfaqes së banimit. Trupi gjykues e mbështeti këtë konkluzion në legjislacionin e zbatueshëm për miratimin e kostos mesatare të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, në të cilin kostoja mesatare e ndërtimit nga EKB-ja, e cila është marrë për referencë nga Komisioni në rastin objekt gjykimi, përcaktohet si vlerë fikse, respektivisht për sipërfaqe ndërtimi apo sipërfaqe shfrytëzimi, pa bërë dallime në llojet e sipërfaqeve sipas funksionit të tyre.

55. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me kundërshtimin e analizës financiare të Komisionit dhe konkluzionit të tij për mungesë të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit në vlerën e 5.220.152 lekëve, për të mundësuar ndërtimin e kësaj pasurie, trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve të arritura më sipër në vendim, në drejtim të përcaktimit të vlerës së objektit, si dhe të periudhës kohore në të cilën është ndërtuar ky objekt, pasi kontrolloi analizën e kryer nga Komisioni nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, arriti në përfundimin se analiza e kryer nga Komisioni është e saktë dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i tij gjendet i drejtë dhe i bazuar.
56. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nëse mblidhen të gjitha të ardhurat e tij ndër vite, dhe kësaj vlere i zbritet vlera e shpenzimeve totale, si dhe vlera e pasurive të krijuara, subjekti do të rezultonte me një bilanc pozitiv, vlerësohet nga trupi gjykues si pretendim i pabazuar. Trupi gjykues nënvizon se analiza financiare për vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve, kryhet duke përllogaritur zërat e të ardhurave, shpenzimeve dhe pasurive të krijuara individualisht për çdo vit dhe duke përballur këtë rezultat me pasqyrën e deklarimeve të subjektit pranë ILDKPKI-së, për të vlerësuar kështu në mënyrë objektive, jo vetëm saktësinë e deklaramit, por dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të deklaruara në vitin e krijimit dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera për njësinë ekonomike familjare.
57. Në lidhje me pretendimin e subjektit se shpenzimet për murin rrethues nga Komisioni janë llogaritur në vitin 2000, ndërsa subjekti ka pretenduar faktin se në vitin 1996, pas marrjes së lejes së sheshit të ndërtimit, ka bërë rrethimin e sheshit dhe ka vazhduar punimet, trupi gjykues e çmon këtë pretendim të pabazuar në kuadër të konkluzioneve të arritura më sipër në vendim sa i takon periudhës në të cilën është kryer ndërtimi i objektit. Megjithatë, edhe nëse ky pretendim do të pranohej nga trupi gjykues dhe shpenzimet e murit rrethues do të merreshin në konsideratë në përllogaritje në analizën financiare të vitit 1996, dhe jo në atë të vitit 2000, nga verifikimet e kryera nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit do të rezultonte sërish me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme në vlerën e 5.234.552 lekëve, për krijimin e kësaj pasurie.
58. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me kundërshtimin e konkluzioneve të Komisionit lidhur me krijimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “godinë banimi 3 kate + bodrum” me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 299,95 m² dhe sipërfaqe totale të ndërtimit për banim 348,15 m², në qytetin e Kukësit, të legalizuar në vitin 2012, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pasaktë dhe ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për ndërtimin e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
59. *Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit “automjet” të tipit Mercedes Benz, blerë në vitin 2011, në vlerën 500.000 lekë, për të cilën subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për deklaramit të rremë të vlerës së automjetit dhe mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e tij, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
60. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ndër të tjera, si vijon: *Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe të rrethanave sa më sipër arsyetuar, në raport me prapësimet e subjektit në rezultatet e hetimit administrativ, për të cilat pas përllogaritjeve financiare të pasqyruara në tabelën nr. 4, subjekti*

rezultoi në pamjaftueshmëri financiare të burimit të ligjshëm për këtë pasuri, çmon se: i. Subjekti është në mungesë burimesh financiare në vlerën 938.091 lekë për të blerë automjetin, për të paguar zhdoganimin dhe për të kryer shpenzimet të tjera familjare. ii. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën periodike për vitin 2010, pasi nuk ka deklaruar pagesën e zhdoganimit të automjetit. iii. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën “vetting”, pasi deklaroi shpenzime zhdoganimi në vlerën 260.102 lekë, ndërsa nga dokumentacioni i DPSHTRR-së, shpenzimet e zhdoganimit rezultuan në vlerën 470.254 lekë.

61. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të pabazuara konkluzionet e Komisionit për deklaram të rremë të vlerës së automjetit dhe mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e tij. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, subjekti pretendoi se ka deklaruar vlerën e automjetit në përputhje me kontratën e shitblerjes së mjetit në datën 17.01.2011 dhe se vlera prej 1.999.000 lekësh, e llogaritur nga ana e Credins Bank si vlerë e automjetit mbi të cilin është vendosur barrë sigurorese, nuk mund të merret për bazë për të arritur në konkluzionin se është kryer deklaram i rremë i vlerës së automjetit. Gjithashtu, edhe vlera referuese mbi bazën e së cilës është përcaktuar tarifa doganore, nuk përbën provë të faktit se kjo është vlera e automjetit. Subjekti pretendoi edhe se ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e tij dhe pagesën e tarifës së zhdoganimit në vlerën prej 260.102 lekësh, të cilën e mbështet edhe me një relacion financiar të hartuar nga eksperti kontabël E. M. nga “{***}”ShPK.
62. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstatoi se pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të kundërshtimit të deklaramit të rremë të vlerës së automjetit, nuk u referohen konkluzioneve përfundimtare të Komisionit lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie të subjektit të rivlerësimit, por konkluzionit të ILDKPKI-së në raportin e saj të vlerësimit, konkluzion i cili rezultoi se nuk është konfirmuar nga ana Komisionit në vendimin e tij. Në këtë kuptim, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mungesë deklarami të rremë, çmohen nga trupi gjykues se nuk kanë bazë faktike mbi të cilën të mund të ngrihen dhe të merren në shqyrtim.
63. Në lidhje me çështjen e tarifës së zhdoganimit të automjetit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, referuar ankimit të tij, nuk ngre ndonjë pretendim konkret të shprehur në drejtim të vlerës së tarifës së zhdoganimit të automjetit. Ai tenton të sqarojë situatën në drejtim të vlerës së referencës së automjetit, por ndërkohë merr të mirëqenë faktin se ka kryer si shpenzim për zhdoganimin vlerën prej 260.102 lekësh dhe jo vlerën prej 470.254 lekësh, çka pasqyrohet dhe në relacionin financiar të paraqitur prej tij së bashku me ankimin.
64. Në kuadër të shqyrtimit të sa më sipër, nga verifikimi i akteve të fashikullit të përcjellë nga Komisioni, trupi gjykues konstaton faktet dhe rrethanat e mëposhtme lidhur me transaksionin e shitblerjes së automjetit objekt kontrolli.
 - 64.1. Referuar dosjes së automjetit të tipit Mercedes Benz, me targë {***}, të përcjellë pranë Komisionit nga DPSHTRr-ja¹⁸, vihet re se për blerjen e këtij automjeti, subjekti i rivlerësimit ka lidhur një kontratë shitblerjeje automjeti me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.01.2011, sipas së cilës ka blerë nga z. E. A., automjetin {***}, me vit prodhimi 2003, në vlerën e 500.000 lekëve.
 - 64.2. Në dosjen e automjetit, përveç kontratës së shitblerjes së automjetit, certifikatës së kontrollit fizik të mjetit dhe certifikatës së pronësisë së mjetit, ndodhet edhe praktika e zhdoganimit të tij. Trupi gjykues vëren se në këtë praktikë ndodhen dy deklarama, të cilat kanë të bëjnë me zhdoganimin e mjetit dhe kanë të njëjtin numër reference doganore {***} dhe të njëjtën datë

¹⁸ Me anë të shkresës me nr. {***} prot., datë 15.05.2018.

14.01.2011, por paraqesin vlera të ndryshme të tarifës së zhdoganimit, ku në njërin prej tyre paraqitet vlera prej 260.102 lekësh, ndërsa në tjetrën vlera prej 470.254 lekësh.

64.3. Nga këqyrja me sy të lirë e këtyre dy deklaratave, konstatohet se në asnjërën prej tyre nuk ka ndonjë vulë revokimi, sikundër dhe nuk konstatohet asnjë element i cili të qartësojë trupin gjykues në drejtim të verifikimit të faktit se cila deklaratë është lëshuar e para dhe cila e dyta. Trupi gjykues gjithashtu konstaton se në dosjen e automjetit nuk ka asnjë mandatpagesë të lëshuar për pagesën e tarifës së zhdoganimit të këtij automjeti, çka vështirëson arritjen e një konkluzioni se cila është tarifa që duhej të paguante subjekti i rivlerësimit dhe cilën ka paguar ai. Qartësia lidhur me sa më sipër do të mundësonte trupin gjykues për të vlerësuar pozicionin e subjektit të rivlerësimit jo vetëm në drejtim të saktësisë së deklaramit të tij lidhur me këtë vlerë në deklaratën e pasurisë *vetting*, por edhe në drejtim të kontrollit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, duke përfshirë dhe këtë shpenzim të dedikuar.

64.4. Referuar akteve të fashikullit të Komisionit, nuk konstatohet që Komisioni të ketë kryer hetime të mëtjshme pranë organit kompetent në drejtim të qartësisë të kësaj situate dhe faktit se çfarë vlere kanë këto dy deklarata në drejtim të detyrimit doganor të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, konstatohet se Komisioni në vendimin e tij nuk ka shpjeguar arsyet se pse ka pranuar njërin deklaratë dhe jo tjetrën dhe as ka arsyetuar në lidhje me pasojat që kjo situatë faktike ka për subjektin e rivlerësimit, edhe pse konstatohet që nga faza e rezultateve të hetimit në vendimin përfundimtar ka ndryshuar qëndrimin e tij nga “deklarim i rremë në deklaratën *vetting* lidhur me vlerën e zhdoganimit” në “deklarim të pasaktë”.

- 65.** Në analizë të fakteve dhe rrethanave të sa më sipër referuar, trupi gjykues vlerëson se hetimi i Komisionit në drejtim të verifikimit të shpenzimeve për blerjen e këtij automjeti, nuk ka qenë i plotë, për rrjedhojë kjo paqartësi e krijuar nga dokumentacioni i administruar nga organi shtetëror nuk mund të vlerësohet në dëm të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit dhe përballimin e shpenzimeve të tjera lidhur me të, duhet të vlerësohet sipas variantit të pagesës së vlerës më të ulët të detyrimit doganor.
- 66.** Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për konkluzion të pabazuar të Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të blerë automjetin objekt kontrolli, vlerësuar ky pretendim në kuptim të konkluzioneve të arritura në paragrafin e mësipërm, trupi gjykues, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit lidhur me krijimin e kësaj pasurie, konstatoi se subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit në një vlerë prej 712.612 lekësh. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se lidhur me pasurinë automjet të tipit “Mercedes Benz”, blerë me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.01.2011, para noterit publik B. Gj., në vlerën e 500.000 lekëve dhe detyrim doganor në vlerën e 260.102 lekëve, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- 67.** Trupi gjykues konstaton se lidhur me pasurinë automjet të tipit “Audi”, blerë me kontratën e shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.03.2003, para noterit publik B. Gj., në vlerën e 1200 eurove dhe detyrim doganor në vlerën e 292.500 lekëve, subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Në kushtet që subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur në ankimin e tij asnjë shkak konkret për

kundërshtimin e vlerësimit të Komisionit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konfirmon qëndrimin e Komisionit lidhur me rezultatin e kontrollit të krijimit të kësaj pasurie.

68. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, pika 5, germat “a” dhe “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 210, datë 14.11.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Isuf Shehu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 15.11.2021, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi